

Dashuri vëllazërore

Një ftesë drejtuar të gjithëve

Mbreti do të përgjigjet: " Për të vërtetë po ju them: cka do bëtë për njërin ndër këto vëllezër të mi më të vegjël, e bëtë për mua" (Mt.25,40)

Sezoni veror i Nocerës " Të hapesh rrugica", na kërkon detyrimin tonë për të hapur rrugë, të lëvizim në drejtim të mikëpritjes së ndryshimit, të jemi dëshmitarë të dashurisë në një shoqëri të sëmurë dhe egoiste, të kthehemi tek burimet e besimit dhe të zgjedhjes tonë për të jetuar një jetë shpirtërore bashkëshortore në Equipe Notre - Dame.

Përshkruajmë këto rrugica me shpirtin udhëtar e të lirë, pa marrë asgjë për udhëtim sepse cdo gjë do ti dhurohet nga Zoti , nëpërmjet Fjalës së Tij, nëpërmjet personave të cilët i njohim jo si " të tjerët" por si "vëllezër" pasi jemi bijë të të njëjtit Zot ashtu sic na ka mësuar Jezusi.

Mundësia për të kuptuar thelbin e kësaj lloj jetese, të përbërë nga mikëpritja dhe vëllazëria, na jepet gjatë detyrës për tu ulur e bashkëbiseduar, gjatë ecjes, nëpër rrugët e qendrës, në përqëndrimin tonë për të komunikuar aq sa mos të mos kuptojmë që shiu ka filluar të bjerë; kërkojmë një strehë në monastirin e Badia Fiorentina në të cilën mirëkpritemi nga një e shkruar mirëseardhjeje : "**Kërkoj çdo ditë Zotit që të ruaj në zemrën tënde dashurinë për vëllezërit e të vë në zemrat e tyre dashurinë për ty**".

Dashuria është filtri nëpërmjet të cilit përzgjedhim, seleksionojmë zgjedhjet tona, nëpërmjet të cilit krijojmë mardhënje me personat me shokët e vëllezërit.

Dashuri e mirëkpritur dhe e dhuruar. Njëra nuk mund të ekzistojë pa tjetrën e një gjë të tillë na e mëson Maria e cila pasi mori lajmin e mishërimit të Dashurisë në trupin e saj nxitohet ta komunikojë, duke bërë jeshmarrëse kushërirën e saj Elisabeta. Ndjejmë edhe ne urgjencën e komunikimit , jemi të ndërgjeshëm se si e gjithë jeta jonë është e ndriçuar dhe e ushqyer nga Dashuria, nga prania e gjallë dhe aktive e Zotit përkrah nesh gjatë rrugës sonë, e njohur në fytyrën e çdo personi që takojmë në jetën e përditëshme.

Papa Francesku, me rastin e ditës së 27-të të paqes, pohon: " *vëllazëria është një dimension i domosdoshëm për njeriun, i cili është një qenje që kërkon gjithmonë mardhënje. Ndërgjegjshmëria e gjallë e kërkesës për mardhënje na bën që të trajtojmë çdo person si një motër e si një vëlla të vërtetë; pa këtë është e pamundur ndërtimi i një shoqërie të drejtë, të një paqe të gjatë dhe të fortë. Duhet kujtuar se kjo vëllazëri zakonisht mësohet në gjirin e familjes, sidomos falë rolit të përgjegjshëm e plotësues të të gjithë pjestarëve të saj, në veçanti të babait dhe nënës. Familja është burimi i çdo lloj vëllazërie për këtë arsye është themeli dhe rruga kryesore e paqes pasi për thirrje hyjnore duhet të infektojë botën me dashurinë e saj.*"

Është Jezu Krishti i cili duke u bërë i afërmi në historitë tona, na komunikon "mënyrat", na kërkon të forcohem të përfshihemi në procesin e kujdesjes për vëllezërit; me dashuri, një sem bujarisht fekondues të trasmetuar tek secili prej nesh, na shtyn e tërheq drejt njëri tjetrit... aq sa të marrë përsipër "sfidën për të zbuluar dhe të përcjellë ideologjinë e të jetuari sëbashku, të përzihemi, të takohemi, të marrim në krah, të mbështetemi, të marrim pjesë tek kjo dallgë kaotike por e cila mund të shndërrohet në një eksperiencë e vërtetë vëllazërie, në një dallgë solidariteti, në një pelegrinazh të shejtë" (siç inkurajon Papa Francesku në *Evangelii Gaudium* 87).

Fjala e Hyjit e mishëruar, na thërret në veprimet më të tihjeshta, na kërkon të vihemi përkrah e të ecim bashkë më të afërmin tonë, të ndajmë bashkë histori gëzimi e hidhërimi. Çifti thërritet të jetë mishërim i Fjalës: jemi në sot këtu të bëjmë aktuale historinë e dashurisë që Zoti jeton bashkë me të gjitha krijesat e tij duke njohur në secilën prej tyre fytyrën e tij.

E megjithatë ndjehemi sikur të ishim pezull midis dëshirës për tu bërë dhunti dhe ndjenjës për të qëndruar në mënyrë egoiste të mbyllur në botën tonë të vogël, të ankoruar në sentimente keqdashëse e shkatërruese. " *Në shumë anë të botës- na kujton Papa Francesku- shkelja e rëndë e të drejtave fundamentale të njerëzimit duket sikur nuk njeh fund, mbi të gjitha e drejta e jetës dhe ajo e lirisë së besimit. Përbën një shembull shqetësues fenomeni tragjik i trafikut të qënjeve njerëzore, mbi jetën dhe dëshpërimin e të cilëve bëhen spekulime nga njerëz pa ndërgjegji, pa ndjenja. Luftave që luftohen me përballje armësh i shtohen luftat më pak të dukshme por jo për këtë arsye janë më pak të pamëshirshme, të cilat luftohen në fushën ekonomike dhe atë të financës me mjete po aq shkatërruese të jetëve, të familjeve, të firmave. Globalizimi, siç pohoi Benedetto XVI, na afron me njëri tjetrin*

por nuk bën që të jemi vëllezër. Për më tepër shumë situata të paekuilibruara, të varfërie dhe padrejtësie shënojnë jo vetëm një mungesë të thellë vëllazërie por edhe mungesën e një kulture solidariteti. Ideologjitë e reja të karakterizuara nga një individualizëm i shumëpërhapur, egocentrizëm dhe të një konsumizmi materialistik dobësojnë lidhjet shoqërore, duke ushqyer një mentalitet të "pa vlerë" e cila çon drejt përbuzjes dhe braktisjes së personave më të dobët e të atyre të cilët konsiderohen "te kotë".

Këto pohime na kujtojnë te jemi të kujdesshëm dhe të shohim përtej paraqitjes së jashtme që të tjerët na prezantohen, nga frika se zbulojmë në këto persona të njëjtat sjelljet e brishta dhe delikate që strehohen në jetën tonë e drejtojnë zgjedhjet tona. Nëse çdokush do të kishte kurajon ti hapej të tjerëve pa frikë ose pa maskë do të zbulonte sa gjëra të përbashkëta do të kishte në këtë eksperiencë jete, kur Hyji shfaqet tek të gjithë e nuk braktis asnjë. Nuk mund të bëjmë të heshtë këtë zë me të cilin Hyji na thërret; dëgjimi i përditshëm i fjalës së Zotit, pikë kyçe në misionin e impenjimit në Metodo END, është një moment i rëndësishëm i cili na ndihmon të jetojmë me dashuri, për dashurinë dhe në dashuri mardhëniet me Zotin, me bashkëshortin/en dhe vëllezërit. Vëmëndja tek Fjala sjell në jetën tonë dritën e nevojshme për të kuptuar, për të dalluar për të dalë nga ajo bota jonë e vogël e të hidhemi në projekte të rëndësishme për Hyjin. Ajo vë në dukje karakteristikat e birit të Zotit; është e Jezu Krishtit gjurma gjenetike për të cilat flitet në Ungjillin. Është një fjalë e cila ngelet, strehohet, reagon dhe jeton tek ne, në heshtjen e meditimit merr jetë, mishërohet dhe udhëheq zgjedhjet tona duke na dhënë kurajo për të provuar, duke shkuar përtej sipërfaqes e duke penetruar, pikë pikë në historinë e njerëzimit.

Nganjëherë është e vështirë të shrehësh shenja mirëkpritjeje, faljeje, falenderimi edhe midis çiftit dhe " Të lutem, faleminderit, me fal" nuk janë vetëm fjalë e nuk mund të thuhet duke mos i dhënë vlerën e duhur: secila prej tyre kërkon para se të shprehet me fjalë një vetëdije në zëmer, një ndryshim tek personi, një sjellje të nevojshme e domosdoshme për bashkëbisedim në personin që i shqipton; gjuha e zemrës nuk është gjithmonë e lehtë por është e domosdoshme dhe e vlefshme.

Në çdo komunitet, nga kryefamilja e më tej, kur mungon paqja, lindin xhelozitë, zilitë, inati duke shkaktuar përcarje të thella dhe paaftësi për të komunikuar dashuri reciproke.

Mos të lejojmë që ndjenjat e këqija të na përpijnë, por le të kërkojmë gjithmonë të jetojmë me pasion çdo lidhje njerëzore, me të vetmen dëshirë e të qenit të bashkuar me vëllezërit.

Nicoletta dhe Andrea Zanieri

Përgjegjës Regione Centro

Jemi krijuar të aftë për të dashur

Kisha nevojë për një shpëtimtar pasi dashuria që qëndron tek ne rrezikon vazhdimisht të zbehet nga egoizmi, të prengoset nga posesiviteti, të përçahet nga urrejtja, nga inati, nga ndarjet.

Për dhuntinë e Zotit

Vetëm Zoti mund të shpëtonte këtë dashuri të brishtë, ta lironte nga skllavëria e mëkatit. Vetëm një dashuri e cila kishte si burim Dashurinë mund të ja mbathte nga një sjellje sipërfaqësore dhe e kohës së shkurtër. Jezu Krishti, duke marrë përsipër mëkatet e botës, duke sjellë në zemrën njerëzore dashurinë hyjnore të plotë na bën të aftë të duam. Dashuria njerëzore me fjalë të tjera është dashuri ashtu sic njeriu është thërritur ta jetojë, njeriu i bërë i aftë ta jetojë falë vullnetit të Zotit i cili nuk mund të komandojë: "Doni njëri tjetrin" pa na dhënë, në të njëjtën kohë aftësinë për të dashur ashtu "siç" ai na deshi.

Kjo dashuri njerëzore jo vetëm që është shpëtuar dhe restauruar por për më tepër është ngritur akoma më shumë. Dhe ja ku është vënë në lëvizje deri sa u shndërrua, në vëllezërinë në të cilën dishepujt e Jezu Krishtit japin dëshminë e tyre "Nëse e doni njëri tjetrin, të gjithë do tju njohin se jeni nxënësit e mi" (Gjn 13,35).

Lëvizi deri sa u shndërrua, në martesë, simboli dhe shenja e dashurisë midis Krishtit dhe Kishës. Fjala e Zotit realizon atë çfarë deklaron: Jezu Krisht na ri-kthen mundësinë për të dashur sërish.

Kontributi i sforcimit tonë

Për këtë arsye nëse duam të ja lejojmë vetes këtë krahasim, mrekullia e Zotit nuk funksionon si një ashensor i cili do të na dërgojë sa hap e mbyll sytë, pa asnjë mundim nga ana jonë, në një nivel më të lartë perfeksionimi.

Mrekullia e zotit i bën thirrje lirisë sonë. Duke na kërkuar të duam e duke na propozuar mënyrën e tij të së dashuri si një model për mënyrën tonë, Jezu Krishti na fton të bashkëpunojmë me të gjitha forcat tona për shpëtimin dhe promovimin e dashurisë...Një detyrë e mrekullueshme, plotësisht e denjë të lëvizë të gjitha forcat dhe energjitë tona fizike dhe shpirtërore! Pa krijuar illuzione për të arritur të vetëm në një dashuri me vlera të kënaqshme, duhet të dimë që jemi ne që duhet të jemi të gatshëm. Për këtë detyrë që na pret nuk duhet të injorojmë kushtet që na kërkohen. Le të kujtojmë disa prej tyre.

Duhet vëmëndje dhe hapje konstante drejt Shpirtit të Shejtë, i cili na prezanton me dashurinë e Atit dhe të Birit dhe që sygjeron aftësive tona krijuese gjithçka Zoti pret prej nesh.

Duhet durimi dhe ecje të gjata, në të cilën prova dhe kryqi merren përsipër ashtu siç e mori Jezu Krishti, si hapat e preferuara të planifikimit, të plotësisht, të shndërrimit të dashurisë sonë njerëzore.

Duhet besim në Atë i cili nëpërmjet të gjitha dobësive tona, cilat do qofshin pamjet e menjehershme, mundet dhe dëshiron që dashuria të realizohet.

Realizimi i dashurisë është kungimi. Ajo na është premtua në Mbretëri, në të cilën Zoti do jetë gjithçka tek të gjithë (ICo.15,28) Ajo është e marrë nga Krishti i cili është gjithçka tek të gjithë (Col 3.11). Ajo duhet të jetë prioriteti në raportet tona njerëzore dhe në detyrimet tona tokësore, në mënyrë që duke marrë jeshë në dashurinë e të Atit dhe të Birit, ne vetë sforcohemi për të qenë gjithçka tek të gjithë...

Nëse ka dicka që bie në pah tek Shfaqja, është fakti që vizatimi i Zotit bënte fjalë për njerëzimin e ishte një vizatim dashurie. Të bësh pjesë në vizatimin e Zotit i cili na dashuron do të thotë ti përgjigjemi duke dashur edhe ne. Dashuria e Zotit dhe dashuria e te afërmit janë polet e një jete të krishtertë.

Është e lehtë të jesh besnike kësaj dashurie, absolutisht jo. Por ne jei në dijeni që Zoti i cili na thërret për këtë na bën të jemi të aftë ditë pas dite.

Ky besim do të bëjë që të mos humbasim kurajon nga vështirësitë dhe nga "pamundësitë" për të dashur. Një i krishterë nuk do të dijë të dyshojë për dashurinë.

Roger Tandonnet,s-j

Këshilltarë i Lëvizjes pas Atë Caffarel